



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 750B Prot.

Roskovec, më 31.12 2020

VENDIM

NR 98 .DATË 30.12 .2020

“PËR LIDHJEN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT “MBI ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR NDËRTIMIN E NJË BANESE ME KOSTO TË ULËT NË BASHKINË ROSKOVEC”

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 24 pika 2 dhe 3, Ligjit Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit me Entin Kombëtar të Banesave “Mbi zbatimin e programit për ndërtimin e një banese me kosto të ulët në Bashkinë Roskovec”.
- 2- Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit “Mbi zbatimin e programit për ndërtimin e një banese me kosto të ulët në Bashkinë Roskovec”.
- 3- Pjesë përbërëse e Vendimit është Marrëveshja e Bashkëpunimit “Mbi zbatimin e programit për ndërtimin e një banese me kosto të ulët në Bashkinë Roskovec”.
- 4- Ngarkohet Drejtoria Juridike me zbatimin e këtij vendimi.
- 5- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7509 Prot.

Roskovec, më 31.12, 2020

VENDIM

NR 99 .DATË 30.12 .2020

“PËR
KRIJIMIN E MUZEUT HISTORIK ROSKOVEC”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 25, pikat 1 dhe 2, nenit 54, shkronjat “ç”, “d”, “dh” dhe “f”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 214, pika 2, nenit 233, pika 3, shkronja “b”, nenit 275, pika 1, të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 5, shkronja “d”, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; pikës 17, të vendimit nr. 165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njërive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. **Krijimin e Muzeut Historik Vendor Roskovec**, si institucion në varësi të Bashkisë së Roskovecit, me seli në adresën : ish godina e institucionit të bashkisë Roskovec, Qendër , Roskovec.
2. Miratimin e **statutit** të Muzeut Historik Vendor të Bashkisë Roskovec, sipas lidhjes nr. 1 , bashkëlidhur.
3. Miratimin e **strukturës organizative** dhe nivelin e pagave për punonjësit e Muzeut Historik Vendor të Bashkisë Roskovec , sipas Lidhjes nr.2 bashkëlidhur.
4. Miratimin e **formatit dhe çmimit të biletës** për hyrjen në Muzeun Historik Vendor të Bashkisë Roskovec si dhe lehtësimet/përrjashtimet për disa kategori, sipas Lidhjes nr. 3, bashkëlidhur.
5. Ngarkohet Komisioni i Posacëm i ngritur me zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7510 Prot.

Roskovec, më 31.12 2020

VENDIM

NR 100. DATË 30.12 .2020

“ PËR

MIRATIMIN, PËR APLIKIM TË BASHKISË ROSKOVEC NË PARTNERITET ME
SUBJEKTIN/SUBJEKTET PRIVAT PËRKATËS,
NË PROGRAMIN “IPARD II”, THIRRJA III-TË, TË AZHBR-SË.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 27, nenit 28 nenit 33 pika 1 gërmat “ç” dhe “d”, neni 54 , gërma “d”; ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” I ndryshuar, nenet 105-153; Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” nenet 26, 28, 32 dhe 36 të tij; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 709, datë 29.10.2014 “Për Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020”, Vendimit nr.30 datë 19.04.2018 të Këshillit Bashkiak Roskovec për miratimin e dokumentit strategjik “Studim mbi Zhvillimin e Bujqësisë në Bashkinë Roskovec” miratuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresë nr.612/1 prot.datë 30.04.2018; si dhe Thirrjes së tretë për aplikime nr.03/2020 nga Programi “IPARD II” të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ,Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1.Miratimin për aplikim të Bashkisë Roskovec në partneritet me subjektin/subjektet private përkatëse, në programin “IPARD II”, THIRRJA III-të, të Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, për të përfituar grante për investime në asetet fizike për ndërtimin e pikës së grumbullimit dhe përpunimit të produkteve agrobujqësore (linjë grumbullimi dhe përpunimit të produkteve bujqësore (fruta-perime) të ngrira).
- 2.Miratimin e kontributit për aksionet në natyrë konkretisht sipërfaqen prej 40 000 (dyzetëmijë) m2 , nr.pasurie 406/1 , pronë e bashkisë Roskovec sipas çertifikatës për vërtetimin pronësie nr.438237 datë 15.11.2011 (bashkëlidhur) si dhe planvendosjes për këtë sipërfaqe (bashkëlidhur) , për ndërtimin e pikës së grumbullimit dhe përpunimit të produkteve agrobujqësore.
- 3.Miratimin e aktit të themelimit të kësaj shoqërie aksionere (bashkëlidhur), me qëllim zhvillimin ekonomiko-bujqësor të Bashkisë Roskovec.
- 4.Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm,Drejtoria Ekonomike,Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me zbatimin e këtij vendimi.
- 5.Ky vendim hyn në fuqi në bazë të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.

